



Република Северна Македонија
Republika e Maqedonisë së Veriut

АПЕЛАЦИОНЕН СУД ГОСТИВАР ГЈУКАТА Е АPEЛИТ ГОСТИВАР

Ул. Живко Брајковски бр.1, 1230 Гостивар / тел: 042-221-544 / info@asgostivar.mk
Rr. Zhivko Brajkovski nr.1, 1230 Gostivar / tel: 042-221-544 / info@asgostivar.mk

AGJ.nr.04-80/22
29.12.2023
Gostivar

Në bazë të nenit 92 paragrafi 2 të Ligjit për Gjykatat ('Gazeta Zyrtare e RM-së', nr. 58/2006, nr. 62/2008, nr. 35/2008 dhe nr. 150/2010) dhe seanca e gjykatësve në Gjykatën e Apelit Gostivar të mbajtur më datë 29.12.2023, Kryetari i gjykatës Bekim Mehmedi, shpalli programin e mëposhtëm:

PROGRAMI

për punë në Gjykatën e Apelit në Gostivar për vitin 2024.

Në bazë të nenit 92 paragrafit 2 të Ligjit për Gjykatat dhe nenit 7 të Rregullores së Punës së Gjykatës, seanca e gjykatësve përcakton programin e punës së Gjykatës me propozimin e kryetarit të gjykatës.

Gjykata e Apelit në Gostivar realizon juridiksionin e saj kushtetues dhe juridik si gjykatë dytësore në vend në pajtim me kushtetutën, ligjet, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me ligjin, rregulloren e punës së gjykatës dhe aktet tjera nënligjore.

Përmes zgjidhjes së një numri më të madh të lëndëve, me cilësi më të lartë të vendimeve të përgatitura gjyqësore, zgjedhja e lëndëve në afatet e përcaktuara sipas ligjeve të procedurës, rregullores së punës së gjykatës dhe programit të punës së Gjykatës së Apelit Gostivar, si dhe duke reduktuar numrin e lëndëve të vjetra të pazgjedhura në gjykatë, Gjykata e Apelit në Gostivar duhet të jetë më efikase dhe më cilësore në punën e saj.

Programi i punës së Gjykatës së Apelit të Gostivarit për periudhën prej 01.01.2024 deri më 31.12.2024 përcakton punën dhe detyrat nga fusha e veprimit të Gjykatës në procesin e dhënies së drejtësisë me qëllim për të siguruar:

- zgjedhjen në kohë dhe me cilësi të lartë të lëndëve të evidentuara në sistemin AKMIS në këtë gjykatë;

- mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut;
- zbatimimi i paanshëm i ligjit pavarësisht nga pozita dhe karakteristikat e palëve;
- siguria juridike dhe krijimi i kushteve që çdo person të jetojë i sigurt në kuadër të zbatimit të ligjit;
- të ofrohet ndihmë juridike për gjykatat themelore rajonale;
- përgatitja e analizave, informacioneve, indikacioneve, sentencave, etj., të cilat do të ndihmojnë në zbatimin e drejtë të ligjit;
- harmonizimi i punës së kësaj gjykate me punën e gjykatave themelore rajonale përmes raporteve për punën e gjykatave, veçanërisht për lëndët e vjetra të pazgjedhura, përmes vizitave në gjykatat themelore dhe gjatë zgjedhjes së lëndëve konkrete në procedurë ankimore;
- monitorimi i planit për zvogëlimin e lëndëve të vjetra të pazgjedhura në Gjykatën e Apelit të Gostivarit dhe në Gjykatat Themelore në zonën e kësaj gjykate;
- takime dhe konsultime të organizuara me gjykatat themelore rajonale në lidhje me punën e gjykatësve;
- takime në nivel të gjykatave të apelit për barazimin e praktikës gjyqësore, me Gjykatën e Lartë të RMV-së, profesionin e avokatit, autoritetet shtetërore, veçanërisht me Shoqatën e Gjykatësve në lidhje me edukimin e gjyqtarëve dhe me Këshillin për Administratë Gjyqësore dhe organet e tjera shtetërore, për qëllime të edukimit dhe të zyrtarëve gjyqësorë,
- zbatimimi i programit të akademisë për gjykatës dhe prokuror publik dhe personel administrativo-teknik nga Gjykata e Apelit në Gostivar do të realizohet ashtu si është përcaktuar në kalendarin e akademisë.
- përmirësimi dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO9001:2015 përmes kontrolleve të rregullta të brendshme nga verifikues të brendshëm të çertifikuar në Gjykatën e Apelit Gostivar, monitorim të rregullt dhe përmirësim të dokumentacionit të plotë të sistemit me qëllim të raportit pozitiv gjatë inspektimit të jashtëm nga organi çertifikues INTERCERT.

Kryetari i gjykatës, gjykatësit, zyrtarët e gjykatës dhe punonjësit e tjerë të gjykatës janë përgjegjës për zbatimin e programit.

KRYETARI I GJYKATËS

Gjykatësi Bekim Mehmedi, me vendim të Këshillit Gjyqësor të RMV-së nr. 09-1893/1, më datë 09.12.2020, është zgjedhur kryetar i Gjykatës së Apelit të Gostivarit.

Kryetari i gjykatës kryen detyrat e administratës së gjykatës, organizon punën, menaxhon dhe udhëheq gjykatën.

Kryetari i gjykatës do ta përfaqësojë gjykatën dhe do të ndërmarrë masa për kryerjen në kohë dhe të rregullt të punës, do të sigurojë zbatimin e rregullores së gjykatës, do të përcaktojë orarin e punës në gjykatë, do të veprojë sipas kërkesave dhe ankesave të palëve dhe organeve tjera, sipas kërkesave për zgjidhjen me prioritet të lëndëve, pas kërkesave për përjashtim të parashtruara nga gjyqtarët dhe palët dhe do të ndërmarrë veprime të tjera për të cilat është kompetent sipas ligjit dhe rregullores së gjykatës.

Për të siguruar kryerjen në kohë, efikase dhe të rregullt të punës së administratës gjyqësore, kryetari i gjykatës mund t'ia besojë detyrat e punës zëvendësit të tij ose një

gjykatësi tjetër, gjykatësit kryetar të sektorit ose një zyrtari tjetër gjyqësor dhe nëse është e nevojshme, do të organizojë edhe ekipin e tij për punë në zyrë.

Në rast pamundësie ose mungese, kryetarin e gjykatës e zëvendëson zëvendësi i kryetarit të gjykatës.

Kryetari i gjykatës mban rregullisht seancën e gjykatësve me qëllim të shqyrtimit të zbatimit të programit të punës së gjykatës si dhe shqyrtimit, analizimit dhe marrjes së masave pas raporteve për punën e gjykatës, harmonizimit të punës së sektorëve, dhënies së mendimeve në kompetencë të seancës së gjykatësve dhe për çështje të tjera të punës së gjykatës.

Kryetari i gjykatës me kryetarët e gjykatave themelore nga kjo zonë e apelit në takim të përbashkët së paku dy herë në vit do të analizojë të dhënat nga statistikat e gjykatave dhe raportet për punën e gjykatave themelore, të cilët do të marrin masa për unifikimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Apelit të Gostivarit do të vë në dukje dobësitë në punën e gjykatave themelore me propozim për mënjanimin e tyre, për çka do të njoftohen institucionet kompetente në RMV-së.

Në kuadër të fushës së veprimit dhe kompetencës funksionale të kryetarit të gjykatës janë lëndët në regjistrat "SU", "SU-01", "SU-02", "SU-03", "SU-04", "SU-05", "SU.DOV", "SU STR.DOV" , "UPP" dhe SU-IZZ".

PUNA SIPAS LËNDËVE

Qëllimi kryesor gjatë veprimit sipas lëndëve është që të sigurohet veprim trajtim profesional, i paanshëm, me kohë dhe ligjor i lëndëve duke respektuar afatet ligjore dhe afatet e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm në përputhje me dispozitat e rregullores së gjykatës dhe Ligji për menaxhimin e lëvizjes së lëndëve në gjykata, në çdo fazë të procedurës. Regjistrimi, shpërndarja, veprimi, vendimmarrja, publikimi, përgatitja e vendimeve, dorëzimi i vendimeve, anonimizimi i vendimeve në WEB faqen e gjykatës do të kryhet me aplikim të plotë dhe ekskluziv të sistemit të automatizuar kompjuterik për menaxhimin e lëndëve të gjykatës (AKMIS).

Regjistrimi i lëndëve do të bëhet sipas kohës së pranimit, kurse shpërndarja e lëndëve te gjykatësit do të bëhet me shpërndarje automatike në AKMIS. Shpërndarja automatike e lëndëve do të bëhet vetëm në situatat e parashikuara nga rregullorja e gjykatës dhe në përputhje me orarin vjetor të punës së gjykatës, por në ato raste shpërndarja e lëndëve do të bëhet ekskluzivisht me vendim të arsyetuar nga kryetari i gjykatës përmes një moduli të përshtatshëm në AKMIS, me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së parimit të ndarjes automatike dhe përfshirjes së faktorit njerëzor në shpërndarjen e lëndëve për punë të gjykatësve.

Gjykatësit janë të obliguar të kenë përparësi në zgjidhjen e lëndëve që me ligj janë përcaktuar si urgjente dhe për të cilat ka prioritet kryetari i gjykatës.

SEKTORI PENAL

Në sektorin penal me orarin për punë të vitit 2024, janë përcaktuar të punojnë 5 gjykatës, përfshi edhe kryetarin e gjykatës, 1 udhëheqës i sektorit penal, 3 këshilltar gjyqësor, 2 bashkëpunëtor profesional dhe 1 bashkëpunëtor i ri gjyqësor.

Në vitin 2024 sektori penal do të punojë me lëndët KSZH, KZH, KZHM dhe KR me:

- **një** këshill penal me tre gjykatës, që do të veprojnë me lëndët KSZH dhe KR;
- **një** këshill penal me pesë gjykatës, që do të veprojnë me lëndët KZH;
- **dy** këshilla penal që do të veprojnë me lëndët KZH;
- **një** këshill penal për fëmijë, që do të veprojnë me lëndët KZHM;

Në vitin 2024, lëndët penale do të zgjidhen, sa më pak të ndërlikuara brenda 3 muajve, më të ndërlikuara më së voni brenda 6 muajve nga pranimi në gjykatë, përfshirë lëndët për të cilat deklaron prokurori i lartë publik dhe lëndët për të cilat mbahen seancat publike, në kushtet e një numri adekuat të gjykatësve në sektorin penal, pra nëse zgjidhen edhe dy gjyqtarë të tjerë, të cilët do të punojnë në këtë sektor.

Lëndët në sektorin penal do të zgjidhen sipas pranimit të tyre në Gjykatën e Apelit të Gostivarit në pajtim me nenin 134 të rregullores gjyqësore, përveç lëndëve urgjente apo për arsye të tjera të justifikuara.

Sipas nenit 134 paragrafi 2 i rregullores së punës së gjykatës, për zgjedhjen e lëndëve në afatin e caktuar kujdeset gjykatësi i cili është kompetent për të vepruar me lëndët konkrete dhe kryetari i gjykatës.

Secili gjykatës do t'i raportojë kryetarit të gjykatës, duke përgatitur raporte për lëndët e pazgjedhura brenda një afati të caktuar dhe arsyet për të cilat lëndët nuk janë zgjedhur, çdo tre muaj.

Për shkak të mungesës së gjyqtarëve në lëndët penale, gjykatësit nga sektori civil do të përcaktohen si anëtarë të këshillit penal prej pesë anëtarësh, gjithashtu gjykatësit nga sektori civil për shkak të nevojës për përjashtim, mungesë ose pushim dhe nevojë për të kompletuar këshillin do të caktohen si anëtarë të këshillit në sektorin penal.

SEKTORI CIVIL

Në sektorin civil me orarin për punë për vitin 2024, janë përcaktuar që të veprojnë 7 gjykatës, 1 udhëheqës i sektorit civil, 2 udhëheqës të departamentit, 2 këshilltar gjyqësor, 1 bashkëpunëtor profesional dhe 3 bashkëpunëtor të rinj.

Sektori Civil do të punojë në vitin 2024, në lëndët GZH, TSZH, ROZH dhe R me:

- **dy** këshilla civil, që do të veprojnë me lëndët GZH;

- **një** këshill civil me lëndët e kontesteve ekonomike të punës, që do të veprojë me lëndët TSHZ dhe ROZH;

- **një** këshill civil për punët e dëmshpërblimit të dëmeve i cili do të veprojë në pajtim me ligjin për përgjegjësi civile për shpifje dhe ofendim, lëndë me shenjën P5 – vërtetim të përgjegjësisë civile për shpifje dhe ofendim;

- **një** këshill civil të posaçëm i cili do të veprojë lëndët civile të lidhura me falimentim.

Lëndët civile në vitin 2024 që pranohen në Gjykatën e Apelit të Gostivarit dhe janë më pak të ndërlikuara do të zgjidhen në afat prej 3 muajsh nga pranimi i tyre në gjykatë, ndërsa ato më komplekset do të zgjidhen brenda 6 muajve nga pranimi i tyre në gjykatë.

Lëndët do të zgjidhen sipas radhës së pranimit të lëndës në Gjykatën e Apelit të Gostivarit, përveç rasteve urgjente apo raste të tjera të justifikuara, si p.sh. të parashikuar në nenin 134 të rregullores së punës së gjykatës.

Gjykatësi që vepron me lëndët dhe kryetari i gjykatës do të kujdesen për zgjedhjen e lëndëve sipas radhës së pranimit të tyre ose kryesisht duke marrë parasysh rastet urgjente dhe të tjera prioritare.

Secili gjykatës nga seksioni civil dhe penal është i detyruar të informojë kryetarin e gjykatës për lëndët e pazgjedhura brenda afateve të përcaktuara dhe arsyet për të, me një raport me shkrim çdo tre muaj.

Gjatë zgjidhjes së të gjitha llojeve të lëndëve, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet lëshimeve të vërejtura të gjykatave të shkallës së parë në zgjidhjen e lëndëve në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës, paraqitjen e ankesave me lëshime të caktuara dhe dorëzimin me vonesë të lëndëve me ankesë.

Lidhur me lëshimet e konstatuara në gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e shkallës së parë njoftohen gjatë vizitave në gjykatat themelore në zonën e Gjykatës së Apelit Gostivar, si dhe me indikacione të veçanta.

Në rastet kur paraqitet vjetërsimi i ndjekjes penale, i cili është vërejtur gjatë zgjidhjes së lëndëve penale dhe të kundërvajtjes, duhet të shënohen arsyet e vjetërsimit të ndjekjes penale dhe të evidentohet se në cilën fazë të procedurës dhe kur ka ndodhur saktësisht vjetërsimi i ndjekjes penale.

Përveç kësaj, duhet të përcaktohet gjatë zgjidhjes së lëndëve penale sipas paraburgimit, nëse këto lëndë janë dorëzuar me kohë në Gjykatën e Apelit të Gostivarit apo jo, dhe nëse janë me vonesë në dorëzim, të theksohen arsyet për këtë.

Do të analizohet dhe përcaktohet në lidhje me të gjitha llojet e lëndëve nëse gjykatat e shkallës së parë pas anulimit të vendimeve të tyre gjyqësore nga Gjykata e Apelit në Gostivar, a veprojnë sipas udhëzimeve dhe indikacioneve të Gjykatës së Apelit të Gostivarit, si dhe indikacionet e paraqitura në vendimet gjyqësore të Gjykatës së Lartë të RMV-së.

SEKTORI PËR PRAKTIKE GJYQËSORE

Gjatë vitit 2024 në këtë sektor do të punojnë: kryetari i sektorit, kryetari i sektorit penal dhe sektorit civil, ndërsa këtyre do të ju ndihmojnë bashkëpunëtorët profesional, ashtu si është përcaktuar me orarin vjetor të gjykatës së apelit në gostivar për vitin 2024.

Në faqen e internetit të gjykatës, është publikuar formular për praktikë gjyqësore që kryetarët e këshillave duhet ta mbushin me të dhëna pasi që këshilli të ketë vlerësuar se vendimi duhet të shënohet si shembull në praktikën gjyqësore.

Kryetarët e sektorëve e përcaktojnë mënyrën në të cilën sektori për praktikë gjyqësore i evidenton mendimet juridike të pranuar në seancat e sektorëve dhe mënyrën e evidentimit të praktikës gjyqësore me aplikacionin e ri të teknologjisë bashkëkohore, instalimin qendror dhe mirëmbajtje dhe qasje të lehtë.

Në seancën e sektorit do të miratohet plan për ndjekjen e praktikës gjyqësore dhe paraqitjen e dukurive shoqërore dhe raportet për studim të tyre dhe punë të mëtutjeshme, dhe do të formulohen propozime dhe pyetje që fliten në seancat e sektorëve për shkak të marrjes së qëndrimit për barazim të praktikës gjyqësore.

RESURSET NJERËZORE

Me vendim të Këshillit Gjyqësor të RMV-së, u konstatua se funksionin gjyqësor në Gjykatën e Apelit të Gostivarit do ta kryejnë 16 gjykatës, përfshirë edhe kryetarin e gjykatës. Në vitin raportues 2023, funksionin gjyqësor në gjykatë e kanë kryer 11 gjykatës deri në muajin maj, përfshirë edhe kryetarin e gjykatës dhe në maj u bë zgjidhja e dy gjykatësve penal gjegjësisht nga muaji maj deri në muajin tetor funksionin e gjykatësit e kryejnë 13 gjykatës, ndërsa nga muaji tetor deri në muajin dhjetor funksionin e gjykatësit e kanë kryer 12 gjykatës për shkak të pensionimit të njërit gjykatës nga sektori penal në muajin tetor.

Sipas orarit vjetor të punës në Gjykatën e Apelit të Gostivarit për vitin 2024, funksionin gjyqësor do ta kryejnë 12 gjykatës, përfshirë kryetarin e gjykatës, përkatësisht: në sektorin penal 4 (katër) gjykatës dhe kryetari i gjykatës që vepron vetëm me lëndët KSZH dhe KR, kurse në sektorin civil 7 (shtatë) gjykatës.

Duke marrë parasysh numrin e gjykatësve dhe numrin e madh të pozitive të paplotësuar gjyqësore nga njëra anë, dhe nga ana tjetër llojin dhe vëllimin e lëndëve, si dhe kompetencën kushtetuese dhe ligjore të Gjykatës së Apelit të Gostivarit si gjykatë e shkallës së dytë në vend, realisht mund të pritet që gjykatësit të përballen me një ushtrim më të vështirë të funksionit gjyqësor për sa i përket efikasitetit dhe mënjanimit të ndalimit të lëvizjes së lëndëve, nëse gjatë vitit nuk plotësohen pozicionet gjyqësore si dhe vendet e zbrazta të nëpunësve gjyqësor.

Në fund të vitit 2023, me datë 31.12.2023 në Gjykatën e Apelit në Gostivar kanë qenë gjithsej 35 nëpunës gjyqësor dhe 2 personel teknik, përkatësisht: 1 udhëheqës i sektorit penal, 1 udhëheqës i sektorit civil, 1 udhëheqës i sektorit për praktikë gjyqësore, 1 udhëheqës i departamentit gjyqësor – për marrëdhënie me publikun dhe analitikë, 1 udhëheqës i departamentit – për burime njerëzore, 1 udhëheqës i departamentit për informatikë, 4 këshilltarë gjyqësor, 1 këshilltar për prokurime publike, 2 këshilltarë – përkthyes, 3 bashkëpunëtor gjyqësor, 5 bashkëpunëtor të rinj, një bashkëpunëtor i ri – përkthyes, 1 bashkëpunëtor i ri – ekonomist, 1 referent i pavarur udhëheqës i sekretarisë gjyqësore – sektori civil, 1 referent i pavarur udhëheqës i regjistrave në sektorin penal, 1 referent i pavarur – kordinator i zyrës për daktilograf, 1 referent i pavarur udhëheqës i regjistrit të arhivës, 1 një referent gjyqësor i pavarur, 1 referent gjyqësor – kontabilist, 1 referent i ri – kryerje të punëve administrativo teknike, 5 referent gjyqësor – daktilograf, 1 shofer dhe 1 person që kujdeset për higjienën.

Gjykata drejtohet pa administrator gjyqësor, ndërsa detyrat e punës së administratorit të gjykatës i kryen udhëheqësi i sektorit për praktikën gjyqësore, gjithashtu gjykata nuk ka punonjës dhe pjesëtar të policisë gjyqësore.

Sipas Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në këtë gjykatë janë përcaktuar 115 nëpunës, 11 nëpunës persones teknik dhe 8 nëpunës në policinë gjyqësore.

TRANSPARENCA DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Gjykata e Apelit në Gostivar është veçanërisht e përkushtuar për njoftimin me kohë të opinionit për procedurat gjyqësore për të cilat është evident interesi publik. Vetëm me çiltërsi, transparencë dhe sigurim në kohë të informacionit të saktë dhe relevant për gjykatën në procedura të veçanta mund të mbrohet dhe rruhet reputacioni i gjykatës dhe të rritet besimi i publikut në gjykatë. Nga ana tjetër, informimi i saktë dhe në kohë i publikut do të parandalojë publikimin e informacionit të pasaktë nga media, i cili mund të ketë një efekt të dëmshëm si për gjykatën ashtu edhe për palët dhe interesin e tyre.

Për të siguruar këtë detyrë, gjykata do të publikojë rregullisht njoftime në faqen e internetit të gjykatës, dhe përmes zyrës për marrëdhënie me publikun, personave të interesuar do t'u sigurohet qasje në informacionin aktual dhe procedurat e zhvilluara në gjykatë në përputhje me dispozitat e ligjit për menaxhimin e lëvizjes së lëndëve në gjykata.

Gjykata do të caktojë një zyrtar për ndërmjetësimin e informimit publik, i cili do të veprojë në përputhje me dispozitat e Ligjit për qasje të lirë në informata publike.

Vendimet e marra do të jenë të anonimizuara në përputhje me Ligjin për menaxhimin e lëvizjes së lëndëve në gjykata dhe do të publikohen në faqen e internetit të gjykatës, duke i mundur kështu publikut qasje në punën e gjykatës.

PUNA FINANSIARE

Në kuadër të buxhetit të miratuar nga Këshilli Buxhetor Gjyqësor për vitin aktual, do të sigurohet zbatimi në kohë i procedurave të furnizimit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit për furnizim publik dhe përmes menaxhimit të mjeteve financiare do të bëhet përpjekje që të të paguajë me kohë detyrimet në vitin aktual.

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT

Për realizimin me sukses të këtij programi është i nevojshëm proaktiviteti dhe angazhimi i gjykatësve dhe të gjithë punonjësve të gjykatës, për të arritur qëllimet e përcaktuara programore dhe detyrat e përcaktuara.

Mungesa e stafit aktiv gjyqësor krijon presion të madh në efikasitetin dhe cilësinë e funksionimit të Gjykatës.

Për këto arsye, përcaktim kryesor i vendosur programor fokusohet në plotësimin e numrit të gjykatësve, por natyrisht edhe në rritjen e numrit të nëpunësve gjyqësorë duke siguruar mjete financiare për plotësimin e pozitave të nëpunësve gjyqësorë, me mungesën e të cilave gjykata po përballet vazhdimisht, veçanërisht në mesin e stafit profesional.

Përcaktimi i shtuar buxhetor për përmirësimin e sistemit kompjuterik, duke u nisur nga premisa se një investim i duhur në automatizimin e punës rezulton drejtpërdrejt në përfitim për vet stafin njerëzor.

Një nga qëllimet kryesore të programit është edhe forcimi i pozitës së Gjykatës së Apelit të Gostivarit në komunikim me Këshillin Gjyqësor të RMV-së dhe Ministrinë e drejtësisë, e cila do të arrihet duke thelluar bashkëpunimin me Këshillin Gjyqësor të RMV-së përmes bisedave transparente për gjendjen aktuale në gjykata, problemet reale në kryerjen e funksionit gjyqësor dhe sygjerimet për tejkalimin e këtyre problemeve.

AKTIVITETET E ZBATIMIT TË PROGRAMIT

Plani vjetor i vitit 2024 do të zbatohet nëpërmjet aktiviteteve të mëposhme:

- Analiza e lëndëve përmes bashkëpunimit me mbledhje aktive në nivel të sektorit me gjykatësit e Gjykatës së Apelit Gostivar veçmas në sektorin civil dhe sektorin penal.

- Propozime për të cilat vendimet do të referohen si praktikë gjyqësore;
- Ndjekja e praktikës gjyqësore në Gjykatat tjera të Apelit në Republikën e Maqedonisë së Veriut,
- Ndjekja e vendimeve të Gjykatës Supreme të RMV-së;
- Ndjekja e vendimeve të sjella nga gjykata për të drejtat e njeriut në Strazburg;

- Ndjekja e literaturës profesionale ku publikohen vendimet gjyqësore (publikime nga sfera e drejtësisë dhe bulentineve të ndryshme);
- Ndjekja e trajnimeve që organizohen me qëllim të harmonizimit të praktikës gjyqësore dhe atë nga Akademia e gjykatësve dhe prokurorëve publik të RMV dhe organizatave ndërkombëtare.
- Pjesëmarrje aktive për përgaditjen e temave për trajnime me propozime konkrete për tema me qëllim të barazimit të praktikës gjyqësore.
- Përgaditje dhe publikim i Buletineve.
- Raportet mujore – regjistra për mbajtje të mbledhjeve në nivel të Gjykatës së Apelit.

Në sektor do të evidentohen:

- vendimet e Gjyqit Evropian për të drejtat e njeriut;
- vendimet e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ku ka pikëpamje ligjore, punime të ekspertëve dhe rishikimet e botuara në Buletinin e Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Supreme të RMV-së dhe Mbledhjen e Vendimeve Gjyqësore, si dhe Parimet e Gjykatës Supreme;
- qëndrimet e marra të sektorëve të Gjykatës së Apelit për çështjet e veçanta juridike të inicuar nga Gjykata e Apelit në Gostivar dhe Gjykatave Themelore të rajonit të kësaj gjykate.
- pikëpamjet e përbashkëta juridike në nivelin e Gjykatave të Apelit të RMV-së;
- analiza, informacione dhe indikacione të Gjykatës së Apelit Gostivar dhe gjykatave themelore të rajonit të kësaj gjykate;
- sentenca, rishikime dhe materiale të tjera për Buletinin e Praktikës së Gjykatës së Apelit Gostivar ,
- materiale për edukimin e gjykatësve dhe kuadrit profesional në nivel të Gjykatës së Apelit në Gostivar;
- materiale të tjera të rëndësishme për evidentimin dhe praktikën gjyqësore;
- përditësim i rregullt dhe mirëmbajtje e të dhënave për Programën e re të praktikës gjyqësore e cila është plotësisht e ripërpiluar gjatë vitit 2024.

LËNDË TË VJETRA DHE ME PRIORITET

Kryetarët e gjykatave themelore në rajonin e Gjykatës së Apelit në Gostivar, do të monitorojnë punën e gjykatësve përmes programit AKMIS, që është detyrimi i tyre ligjor, do të monitorojnë gjendjen e lëndëve të vjetra të pazgjedhura përmes organeve punuese, dhe për kryetarin e gjykatës do t'i propozojnë masa për përpilimin e planeve për zgjedhjen e lëndëve të vjetra. Kryetarët do të takohen më shpesh për të monitoruar përmbushjen e planit dhe nëse është e nevojshme, ta ndryshojnë dhe plotësojnë atë.

Gjykatësit do të paraqesin raport me shkrim për lëndët e vjetra të pa zgjedhura në raportet mujore me arsyet e mos zgjedhjes dhe një plan kur lënda do të zgjedhet.

Në vitin 2023 është përgjegjësi e të gjithëve, përfshirë edhe Gjykatën e Apelit në Gostivar, që lëndët e vjetra përfshirë 2017 në gjykatat themelore të zgjidhen deri në gjysmën e parë të vitit, dhe lëndët nga 2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023 të zgjidhen deri në fund të vitit.

Gjykatat themelore që kanë lëndë të vjetra në vitin 2024, të kushtojnë vëmendje të veçantë që ky numër i lëndëve të zvogëlohet dhe të vërtetohet arsyeja për moszgjedhjen e lëndëve të vjetra dhe ekzistimin eventual të përgjegjësisë së gjyktësve që nuk i kanë zgjedhur lëndët e vjetra.

Situatat e tilla do të shqyrtohen në mbledhje të përbashkëta në mes kryetarit të Gjykatës së Apelit Gostivar dhe kryetarëve të gjykatave themelore në rajon të kësaj gjykate.

Me zgjedhjen e plotë të lëndëve të vjetra do të kontribuohet në ankesat e qytetarëve për punën e gjykatave, por edhe zvogëlimi i shpenzimeve në buxhetin e Këshillit Gjyqësor për pagesa të kompensimeve për gjykim në afat jo të planifikuar.

Në Gjykatë e Apelit Gostivar planifikohet që në vitin 2024 të mos ketë lëndë të pazgjedhura më të vjetra se 6 muaj nga dita e pranimit të lëndës në këtë gjykatë, me përjashtim të atyre lëndëve që nga arsye objektive nuk kanë mundur të zgjidhen në atë afat kohor.

SHQYRTIME DHE INFORMACIONE PËRMBLEDHËSE

Për vitin 2024 do të përgatiten shqyrtime dhe informacione përmbledhëse.

- përmbledhjen në gjykatë për vendimet e shfuqizuara dhe të ndryshuara nga regjistrat KZH, KZHM, KSZH, PRKZH dhe KR, të cilat do t'i përgatis gjykatësi Abdulbari Ramadani me bashkëpunëtorin gjyqësor Miliat Jashari.

- përmbledhjen në gjykatë për vendimet e shfuqizuara dhe të ndryshuara nga regjistri GZH, do t'i përgatis gjykatësi Velko Strashevski me bashkëpunëtorin gjyqësor Sllagjana Dailoska.

- përmbledhjen në gjykatë për vendimet e shfuqizuara dhe të ndryshuara nga regjistri ROZH, do ti përgatis gjykatësi Izet Ismaili me bashkëpunëtorin gjyqësor Arjeta Iljazi.

- përmbledhjen në gjykatë për vendimet e shfuqizuara dhe të ndryshuara nga regjistri GZH, do ti përgatis gjykatësi Rafis Idrizi me bashkëpunëtorin gjyqësor Aleksandar Duroski.

- informacioni për veprim me lëndët UPP të Gjykatës Apelit Gostivar për vitin 2024 që do të përgaditet nga Kryetari i Gjykatës dhe U.D. Administrator i Gjykatës Sedulla Memedi.

- informacioni për gjendjen me zgjidhjen e lëndëve të vjetra në gjykata themelore për vitin 2024 do t'i përgatisin Kryetari i Gjykatës dhe U.D. Administrator i Gjykatës Sedulla Memedi.

TAKIMET DHE KONSULTIMET

Gjatë viti 2024 janë paraparë takime dhe konsultimet:

- takimet e kryetarit të Gjykatës së Apelit Gostivar me kryetarët e gjykatave themelore në këtë rajon të apelit, për çështje të administratës gjyqësore dhe çështje të tjera aktuale,

- takimet e kryetarit të Gjykatës së Apelit Gostivar me kryetarët e gjykatave të Apelit në Shkup, Shtip dhe Manastir, për çështje aktuale dhe çështje ligjore që lidhen me zgjidhjen e lëndëve,
- takimi i kryetarëve të Gjykatave të Apelit dhe Gjykatës Supreme të RMV-së sipas sektorëve,
- takimi i kryetarit të Gjykatës së Apelit Gostivar dhe kryetarëve të sektorëve me organe dhe institucione të tjera shtetërore për të zgjidhur problemet që do të paraqiten gjatë punës së gjykatës dhe gjykatave themelore të regjionit të Gjykatës së Apelit Gostivar,
- vendim për pjesëmarrje në këshillime, tavolina të rrumbullakëta dhe të tjera, pavarësisht programës së Akademisë, do të sjell kryetari i gjyqit dhe kryetarët e sektorëve në varshmëri të rëndësisë së pyetjeve të cilat do të shqyrtohen në këshillimet e përcaktuara dhe takimet e punës.

Stafi profesional dhe stafi administrativ dhe teknik në Gjykatën e Apelit Gostivar do të marrin pjesë në konsultimet e organizuara nga Akademia për Gjykatësit dhe Prokurorët Publik.

Kryetarët e sektorëve në Gjykatën e Apelit Gostivar, deri në fund të shkurtit të vitit 2024, do të përgatisin programet e punës së sektorëve.

Programi i Punës i sektorëve të Gjykatës Apelit Gostivar do të përcaktojë kalendarin për vizitat e punës dhe mbledhjet e gjykatave të shkallës së parë në rajonin e Gjykatës së Apelit Gostivar për vitin 2024.

VIZITA DHE KONTROLLI I GJYKATAVE THEMELORE LOKALE

Për shkak të ndjekjes së punës në gjykatat themelore në rajon të Gjykatës së Apelit Gostivar, rreth zgjidhjes së lëndëve, dhënia e ndihmës profesionale dhe ndjekja e gjendjes me lëndët e vjetra të pazgjedhura do të përcaktohen dhe realizohen vizita dhe kontrole në gjykatat themelore.

Kryetari i Gjykatës së Apelit Gostivar, së bashku me kryetarët e gjykatave themelore, do të shqyrtojnë gjendjen me udhëheqësinë e administratës, në pajtim me nenin 7 nga Rregullorja gjyqësore.

Gjykatësit do të japin mendimin e tyre:

- nëse ka arsye objektive apo subjektive për zvarritjen e procedurës;
- nëse kanë vërejtje të përcaktuara në lidhje me zgjidhjen e lëndës atë ta përmendim me qëllim që të zgjidhet më shpejtë lënda e vjetër ose e pazgjidhur.

Gjatë kryerjes së vizitave dhe kontroleve për lëndët e vjetra gjykatësit e Gjykatës së Apelit Gostivar do të japin ndihmë juridike për pyetje të posaçme juridike në lidhje me zgjidhjen e lëndës për të cilat më parë kanë kërkuar ndihmë sektorët penal dhe civil të gjykatave, ndërsa do të prezantohen vërejtjet e konstatuara gjatë zgjidhjes në lëndët e shkallës së dytë me qëllim që të mënjanohen dobësitë në zgjidhjen e lëndëve të shkallës së parë dhe do të tregojnë në punë të tjera me rëndësi për punën e gjykatës.

Gjykatësit nga Gjykata e Apelit Gostivar nga sektori penal dhe civil, pas kryerjes së vizitave dhe kontrolleve, do të pregaditë çdokush prej tyre raport të posaçëm për veprimet e ndërmarra dhe vizitat e kryera në gjykatat themelore, në afat prej 8 ditësh nga kryerja e vizitës, raporte të cilat dërgohen deri te Këshilli Gjyqësor i RMV-së, Gjykata Supreme e RMV-së, Ministria e drejtësisë dhe Gjykatat Themelore.

Për shkak të ndjekjes së vazhdueshme të punës të secilit nga gjykatat themelore nga ky rajon i apelit, si dhe për shkak dhënies së ndihmës profesionale, qoftë me kërkesë të gjykatës themelore ose me iniciativë të kësaj gjykate, si dhe me kërkesë të gjykatësit nga gjykata themelore, formohen grupe të veçanta pune dhe në këtë mënyrë për shkak të ndjekjes së vazhdueshme të punës së secilës gjykatë dhe dhënies së ndihmës profesionale me kërkesë të gjykatës themelore ose me iniciativë të Gjykatës së Apelit Gostivar, formohen grupet e punës të poshtëshënuara:

1. Për Gjykatën Themelore Tetovë përcaktohen gjykatësit:

PËR SEKTORIN PENAL,

- Shefajet Hajdari dhe Daut Rustemi,

PËR SEKTORIN CIVIL,

- Velko Strashevski dhe Izet Ismaili.

2. Për Gjykatën Themelore Gostivar përcaktohen gjykatësit:

PËR SEKTORIN PENAL,

- Abdulbari Ramadani dhe Aleksandar Milosheski,

PËR SEKTORIN CIVIL,

- Ali Aliu dhe Rafiz Idrizi.

3. Për Gjykatën Themelore Kërçovë përcaktohen gjykatësit:

PËR SEKTORIN PENAL,

- Shefajet Hajdari dhe Abdulbari Ramadani,

PËR SEKTORIN CIVIL,

- Rafiz Idrizi dhe Zlatko Angjelkoski.

4. Për Gjykatën Themelore Dibër përcaktohen gjykatësit:

PËR SEKTORIN PENAL,

- Aleksandar Milosheski dhe Daut Rustemi,

PËR SEKTORIN CIVIL,

- Afrim Jakupi dhe Liljana Ickova.

Për ndjekjen e gjendjes me gjykatat themelore, gjykatësit të cilët janë të përcaktuar për dhënien e ndihmës juridike nëse kanë nevojë do të kërkojnë nga kryetarët e gjykatave themelore të dhëna të posaçme.

Për përcaktimin e gjykatësve për dhënien e ndihmës juridike dhe ndjekjen e gjendjes në gjykata themelore konkrete nga rajoni i Gjykatës së Apelit Gostivar do të

njoftohen kryetarët e gjykatave themelore, Këshilli Gjyqësor i RMV-së dhe Gjykata Supreme e RMV-së.

Çdo punëtor i stafit tekniko-administrativ punën dhe ta kryejë paster dhe me efikasitet në korniza të detyrave të punës të parapara me aktet e gjyqit dhe ajo që do t'i jepet në besim në punë nga ana e kryetarit të gjyqit dhe është i detyruar të mbajë ditat ku do të evidentojë punët e kryera të përditshme që do të jenë në dobi gjatë vlerësimit të punëve të tyre.

Udhëheqësi i sektorit për praktik gjyqësore Sedulla Memedi do t'i kontrollojnë punët e të gjithë nëpunësve gjyqësor, ardhjen e punëtorëve në vendin e punës, dalja e tyre gjatë orarit të punës, shkuarja e tyre nga puna dhe disciplina e tyre gjatë kryerjes së detyrave të punës.

Meqenëse në Gjykatën e Apelit në Gostivar nuk ka asnjë pjesëtar të policisë gjyqësore, siguria e objektit të gjykatës, njerëzve dhe objekteve, ashtu siç është paraparë me Planin e sigurisë të miratuar nga kryetari i Gjykatës së Apelit të Gostivarit, do ta kryejnë pjesëtarët e policisë gjyqësore në Gjykatën Themelore të Gostivarit, të cilët janë të detyruar të mbajnë evidencë për hyrjen dhe daljen e palëve nga objekti i gjykatës.

Për realizimin e këtij Programi, përgjegjës është kryetari, gjykatësit, U.D administratori gjyqësor, nëpunësit gjyqësor dhe të gjithë të punësuarit në gjykatë.

Programi Vjetor do të zbatohet nga data **01.01.2024**.

Kryetar i
Gjykatës së Apelit Gostivar
Bekim Mehmedi